



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS,
01. Nr. 06-3239/17
KLINË, 28.4.2017

PROCEVERBAL
I SEANCËS SË IV-të TË KK, MBAJTUR, MË 28.4.2017, NË SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryetari i Komunës, Sokol Bashota, kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, nënkryetari i Komunës, Enver Berisha, komandanti i policisë, Rexhe Berisha, përfaq. të KFOR-it, përfaq. të OSBE-së, Zyra ligjore, Zyra e Auditimit, Zyra për Informim, OJQ "Zana", etj.

Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrje në këtë seancë të KK.

"Të pranishëm në seancë jemi 14 anëtarë të KK, mund të procedojmë me seancë, kuorumi ekziston, opozita s'kanë arsye për mungesë. Prandaj e konstatoi kuorumin për hir të korrektësisë, për hir të incizimit dhe për hir të transparencës. Prezent në sallë prej 27 këshilltarëve të Kuvendit Komunal jemi 14, ka kuorum dhe mund t'i vazhdojmë punimet, mund të marrim edhe vendime" theksoi kryesuesi Ibishi, i cili në vijim vuri në miratim rendin e ditës.

Me 14 vota për u miratua ky

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i propozimit për vënie në Diskutim Publik të Draft-strategjisë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Klinës 2017-2021,
4. Shqyrtimi i Raportit të Ekzekutivit për periudhën janar-dhjetor 2016,
5. Shqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës lidhur me Planin e menaxhimit të mbeturinave (Plotësim i preambulës me nenin 10 të Ligjit për Mbeturina 04/060) sipas kërkesës së MMPH-së,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për transfero (rialokimit) të mjeteve të buxhetuara në kodin 13810 në kode tjera,

7. Pyetje dhe përgjigje të këshilltarëve të Kuvendit.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Haxhi Ibishi, tha se këta nuk kanë arsye, kjo është e deklaruar.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit të seancës së kaluar. Nuk pati debate. Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

Me 14 vota u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika e tretë: Shqyrtimi i propozimit për vënie në Diskutim Publik të Draft-strategjisë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Klinës 2017-2021.

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes në shqyrtim. Vuri në miratim propozimin për vënie në Diskutim Publik të Draft-strategjisë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Klinës 2017-2021.

Me 14 për u miratua propozimi për Diskutim Publik të Draft-strategjisë për Zhvillim Ekonomik të Komunës së Klinës 2017-2021.

Pika e katërt: Shqyrtimi i Raportit të Ekzekutivit për periudhën janar-dhjetor 2016.

Kryesuesi fjalën e barti te Kryetari i Komunës, Sokol Bashota.

Sokol Bashota, tha se tashmë ju e dini që është bërë praktikë që ne si ekzekutiv të raportojmë në KK. “Ju me siguri e keni marrë materialin me kohë dhe besoj që të gjitha janë të detajuara për gjithë punën e ekzekutivit në komunën tonë. E dini shumë mirë që është rritur performancë e administratës komunale karshi qytetarëve të Komunës së Klinës, po ashtu edhe gama e investimeve është rritur në tërë territorin e Komunës së Klinës. Besoj që keni pasur kokë për ta shqyrtuar materialin edhe kryesuesi ta qet në votim”, ka pohuar kryetari Bashota.

Kryesuesi hapi debatin rreth Raportit të Ekzekutivit për periudhën jana- dhjetor 2016.

Baki Gashi, theksoi se te ndërtimi i objektit të shkollës në Këpuz është bërë gabim teknik, është shkruara “ndërtimi i objektit të shkollës në Sferkë, ndërsa duhet të jetë për shkollën e Këpuzit.

Kryesuesi e vuri në miratim me korrigjimin që bëri drejtori Gashi.

Raporti i Ekzekutivit për periudhën janar – dhjetor 2016 u miratua me 14 vota për, pa kundër as abstenim u miratua.

Kryetari Bashota propozoi që të shkohet në pushim për 30 minuta.

Haxhi Ibishi, theksoi që shkojmë në pushim prej 30 minutave me propozimin e Kryetarit dhe më pastaj propozojmë me pikën e pestë të rendit të ditës.

Pas 30 minutave, gjegjësisht nga ora 11:00 u procedua me vazhdimin e seancës.

Pika e pestë: Shqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës lidhur me Planin e menaxhimit të mbeturinave (Plotësim i preambulës me nenin 10 të Ligjit për Mbeturina 04/060) sipas kërkesës së MMPH-së.

Kryesuesi Ibishi, foli rreth çështjes në rend të ditës. “Kush mund nga Zyra ligjore apo drejtorisë gjegjëse për të na dhënë një sqarim plotësues rreth çështjes së preambulës së nenit 10 të Ligjit të Mbeturinave 04/060, sipas kërkesës së MMPH”, theksoi kryesuesi, i cili në vijim sqaroi vendimin e ministrisë të Administratës së Pushtetit lokal, që ka kontestuar vendimin të AK.

“Duke u mbështetur në nenin 17, nën h, si dhe në nenin 40 nën i të LVL 03/L 040, të nenit 10 të Ligjit për Mbeturinat 04/L060, neni 40, pika, alineja dhe neni 81 të Statutit të Komunës, KK të Klinës në bazë të kërkesës dhe datës 23.3.2017, me numër 1291-2/17, të MMPH-së dhe 2021, i miratuar me 24.2.2017, me numër 0106974/17, KK rishqyrtoi, plotësoi sipas kërkesës vendimin në bazë të miratimit dhe propozimit të Planit mbi vendimin e mbeturinave”, theksoi kryesuesi i cili në vijim sqaroi se neve na është thënë që duhet vetëm të korrigjojmë preambulën e vendimit, të shkruhet neni 10 i Ligjit mbi Mbeturinat, nr. 04/ fraksion n 060, që nuk është hyrë në vendimin bazik. “Kjo është ajo për të cilën na kanë sugjeruar që të kthehet vendimi në rishqyrtim”, sqaroi kryesuesi Ibishi.

Kryesuesi hapi debatin rreth çështjes në shqyrtim.

Tunë Dedaj, theksoi që z. kryesues, të drejtën e fjalës nuk mund të ma marrësh.

“Kryetarit të një grupi parlamentar nuk mund t’ia marrësh fjalën pa folur asgjë. Më së pari kisha për të kërkuar prej jush më këqyrë si keni ardhur deri te pika e pestë e rendit të ditës, nuk keni pasur kuorum. Ne kemi qenë këtu në 9.50 minuta, ju jeni vonuar, ndërsa ju jeni ardhur në 10:17 minuta, do të thotë 17 minuta ju kemi pritur, nuk keni hyrë këtu,

keni qëndruar jashtë, edhe nuk e di si keni ardhur ju në këtë pikë kur nuk keni pasur kuorum për ta mbajtur mbledhjen. Ju mund të thoni që keni pasur kuorumin, mirëpo nuk e keni pasur. Se unë dhe gjithë grupi im i AAK-së e ka parë që Pjetër Coli ka ardhur me shumë vonesë në mbledhje. Nëse e keni filluar pa kuorum e keni shkelur rregulloren e Kuvendit. Edhe kërkoj prej jush që të kthehet prej pikës së parë të rendit të ditës, të fillojë mbledhja, në të kundërtën ne e lëshojmë sallë,” theksoi anëtari Dedaj.

Haxhi Ibishi, theksoi se për sqarimin tuaj edhe të opinionit unë kam pritur këtu për shkaqe teknike, unë nuk ju kam gjetur juve në sallë, ku kam ardhur në 10:13 minuta në sallë. Unë e kuptoj që është kohë fushatë, unë i kuptoi reagimet tuaja, është krejtësisht legjitim, është i drejtë. Nga shërbimi teknik kam qenë i informuar se nuk kemi zërimin ende. Bile-bile deri në 10:27-28 minuta nuk ka qenë teknikisht salla e përgatitur dhe ndërkohë 10:31 – 10:32 i janë bashkëngjitur anëtarë që është bërë kuromi prej 14 anëtarëve. Kështu, ky është qëndrim juaji politik që e respektoj, për të marrë pjesë apo për të mos marrë pjesë. Ju jeni të thirrur për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve këtu në seancë, por edhe mundeni kur të doni për ta lëshuar, edhe çështje tërësisht parimore vlerësimi”, theksoi kryesuesi Ibishi.

Fadil Gashi, tha se po që se doni për të luajtur është diçka tjetër, që doni të gënjeni është diçka tjetër. “Fiks në orën 10:17 minuta kemi dalë. Edhe në korridor jemi dakorduar po dalim ta pimë kur bëheni gati të kthehemi. Edhe nuk është etikë, e para e juaja, është dashur jo për të qëndruar në Korridor, por këtu për të na treguar se nuk ka qenë e gatshme teknika, se kjo nuk qëndron, 3-4 herë e ka provuar ai djali atje edhe funksiononte mirë. Kjo nuk qëndron. Për pjesën tjetër, ju mos bëheni merak që po na jetë hatri që nuk e kemi diskutuar. Se edhe ashtu nuk e kemi pasur në plan për të diskutuar, mirëpo nuk është etike kjo çfarë po bëni, nuk është procedural, edhe ju keni bërë një seancë klendistine, sepse nuk e keni pasur shumicën për të filluar. Ju duhet për t’i pasur minimumin 14 anëtarë për të filluar, edhe nuk i keni pasur. Ndërsa tash që doni për të na nxitur për ta bërë në shkresë për t’ju drejtuar edhe incizimeve, edhe transkripteve e tjerë, të gjithave, nuk dalin ashtu, se keni filluar pa kuorum. Edhe po kërkojmë të kthehemi dhe të diskutojmë. Kjo nuk është ashtu. Nëse ti nuk e respekton si kryesues, pse ti kërkon për të qenë në sallë, kur ne ju pritëm 17 minuta, edhe ju s’keni ardhur, bile për të na arsyetuar përmes shërbimit apo përmes ndokujt. Kjo është. Edhe e dyta, le të jetë edhe kjo tash në shënim: së s’ kthehen unë po ju njoftoj se ne dalim. Ne dalim edhe e di që nuk ju pengojmë asgjë se, jo e di edhe kështu, se për të vjedhur nuk e keni problem. Vidhni edhe seancën, edhe materialin, edhe pikat e rendit të ditës, fare nuk është problem për ju. Port a kesh parasysh se asnjërit prej nesh as materiali nuk na ka ardhur në adresën elektronike. Edhe këtë ta keni parasysh. Që s’kthehen pikat e rendit të ditës, ne e kryejmë seancën dhe ju vazhdoni pa ne”, theksoi anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, theksoi se unë me përgjegjësi të plotë e pohoi që seancën nuk e kam filluar pa kuorum, kam pritur këtu kur janë bërë 14 anëtarë. “Më përgjegjësi e them që prej teknikës kam qenë I informuar që nuk jemi në rregull teknikisht, edhe mund të verifikohen incizimet. Për këtë pjesën tjetër janë incizimet, janë vëzhguesit, janë njerëzit prezent, kanë qenë edhe përfaqësuesit të OJQ-ve, kanë qenë edhe përfaqësuesit të KFOR-it. Është e vërtetë që unë kam pritur, por kam pritur për shkaqe teknike dhe ne kemi proceduar me rastin. Nuk është mbledhje klendistine, nuk ka vendime klendistine, sepse nuk ka asnjë nevojë PDK –ja të mbajë mbledhje klendistine, ka numrat, ka konceptin. Atëherë edhe ato qëndrimet e juaja jo vjedhje, nuk janë korrekte të thuhet në këtë asamble”, theksoi kryesuesi, i cili hapi debatin rreth pikës së pestë të rendit të ditës, Shqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës lidhur me Planin e menaxhimit të mbeturinave (Plotësim i preambulës me nenin 10 të Ligjit për Mbeturina 04/060), sipas kërkesës së MMPH-së”, ka shtuar kryesuesi Ibishi.

Kryesuesi vuri në miratim Vendimin e Kuvendit të Komunës lidhur me Planin e menaxhimit të mbeturinave (Plotësim i preambulës me nenin 10 të Ligjit për Mbeturina 04/060) sipas kërkesës së MMPH-së.

Opozita lëshoi punimet e seancës.

Haxhi Ibishi, theksoi se edhe këtë do ta themi që jeni nënshkruar në letër për mëditje.

Kryesuesi theksoi se edhe ne po e ndërprejmë për 10 minuta seancën, vazhdojmë pas 10 minutave.

Haxhi Ibishi, theksoi se prej 27 këshilltarëve komunale prezent të sallë jemi 14, ka kuorum dhe mund të vazhdojmë punimet, mund të marrim edhe vendime. “Pika e pestë e rendit të ditës është Shqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës lidhur me Planin e menaxhimit të mbeturinave (Plotësim i preambulës me nenin 10 të Ligjit për Mbeturina 04/060) sipas kërkesës së MMPH-së. Pas këtyre sqarimeve shtesë që i bëra unë nëse ka ndokush që ka paqartësi, është çështja vetëm për preambulë, nuk është shkruar numri i ligjit ekzakt, i cili ligj është kompetent për menaxhimin e mbeturinave. Nuk ka në përmbajtje asnjë ndryshim, nuk ka në përmbajtje asnjë kontestim nga ministria për asnjë problem”, pohoi kryesuesi, i cili në vijim e vuri në miratim rekomandimi i ministrisë mbi vendimin e Drejtorisë komunale mbi menaxhimin e mbeturinave.

Me 14 vota për, pa abstenim, pa kundër miratohet rekomandimi i Ministrisë.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për transfer – rialokim të mjeteve të buxhetuara në kodin 1380 (ref. DFEZH – drejtori Ramiz Rrusta).

Haxhi Ibishi, tha se janë disa kode që duhet ekzaktësisht për t'u ripozicionuar mjetet për të pasur mundësi për t'u shfrytëzuar nga drejtoritë gjegjëse edhe ekzekutivi. Kryesuesi fjalën e barti te drejtori i Drejtorisë së FEZH, z. Ramiz Rrusta.

Ramiz Rrusta (drejtor i Drejtorisë së FEZH), raportoi rreth çështjes në shqyrtim. “Ne kemi biseduar edhe në KPF, sepse është një vendim i marrë prej MF për ridestitim apo rialokim të mjeteve. Pikërisht është fjala për paticash, qysh i thonë ekonomistët “para e gatshme”. Kanë qenë të alokuara në një kod tjetër, por MF ka filluar që të ndryshojë edhe kodet, edhe nënkodet, kështu që shuma ka qenë 18 450 euro, që pjesa më e madhe e këtyre mjeteve është për arsim, 13.150 euro, ndërsa mjetet tjera janë duke filluar prej Zyrës së Kryetarit dhe disa drejtori që kanë para të gatshme, është fjala për paticash. Tash është e udhës që të merret vendimi edhe në asamble. Kështu që nuk ka qenë përpara. Të gjitha këto mjete që shfrytëzohen duhet të kenë edhe nënkodin e tyre, po ju them që më parë nuk jemi marrë me këtë problematikë”, ka sqaruar drejtori Rrusta.

Kryesuesi hapi debatin.

Nuk pati debate.

Kryesuesi vuri në miratim propozim-vendimin për transfer-rialokim të mjeteve të buxhetuara në kodin 1380, në kodet tjera sipas propozimit të Drejtorisë së FEZH.

Me 14 vota për, kundër dhe pa abstenim u miratua propozim – vendimi për transfer-rialokim të mjeteve të buxhetuara në kodin 1380, në kodet tjera sipas propozimit të Drejtorisë së FEZH.

Pika e shtatë: Pyetje dhe përgjigje të këshilltarëve.

Haxhi Ibishi, tha se më duhet t'ju informoj se një këshilltari që ka paraqitur pyetjen nga seanca e kaluar përgjigja iu ka dhënë më shkrim, pra përgjigjen e ka marrë me kohë.


Nuk pati pyetje nga ana e këshilltarëve.

Haxhi Ibishi: “Më lejoni t'ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin, njëherësh t'ju shpreh shqetësimin për largimin e opozitës pa asnjë argument, pa asnjë shkas, dhe seancën e deklaroj të mbyllur, njëherësh ekzekutivin e falënderoj për korrektësinë që ka raportuar në vijimësi në këtë AK”, ka shtuar kryesuesi Ibishi.

Kryesuesi seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 11.20 minuta.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI



Kryesuesi i Kuvendit
Dr. Haxhi IBISHI

